

Gjykata e New Jerseyt dha verdiktin e saj final në rastin e pezullimit të ndërtimit të Xhamisë në Bernards Township të NewJersey.

Qyteti në fjalë duhet të paguajë 3.5 milionë dollarë dëmshpërblim Komunitetit Musliman, pasi që kishte penguar ndërtimin e Xhamisë e cila kishte marrë lejën për ndërtim qysh në vitin 2012. Qyteti i lartpërmendur pasi ishte munduar përmes iniciativave qytetare ta ndalojë ndërtimin dhe nuk ia kishte arritur, vazhdoi tutje duke ndryshuar edhe rregullorën për ndërtimin e faltoreve dhe si pasojë u pezullua leja për xhami.

Pasi nuk panë rrugëdalje tjetër Komuniteti Musliman paraqiti Rastin në Gjykatën e New Jersey-t dhe pas vërtetimit të fakteve se u ishte bërë padrejtësi këtij Komuniteti gjykata dënoi Bernards Township me 3.5 milionë dollarë nga të cilat 1.75 Milion shkojnë për harxhime të Gjykatës dhe të tjerat i ndahen Komunitetit Musliman si dëmshpërblim./Shembulli/